

AKT THEMELIMI

PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"BIS" sh.p.k.

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit".

Në përputhje me Ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Unë, Eno Serjanaj, i datëlindjes 09/08/1986, lindur në Berat dhe banues në Berat, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftmin (ID) Nr. 0123456789, përpiloj këtë Akt Themelimi për krijimin e personit juridik, Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), me të dhënat sa vijon:

EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "BIS" sh.p.k.

FORMA JURIDIKE

Shoqëria që krijohet, "BIS" sh.p.k., është e llojit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) sipas ligjit është person juridik i të drejtës shqiptare, në përputhje me Ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit".


SELIA

Shoqëria e ka selinë në adresën: Lagjia 30 Vjetori, Rr. Ndërtuesi, Godinë 1-Katëshe, Nr. 2/2, Berat 5003, Shqipëri. Z.K 8502, Nr. Pasurie 14/13. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

OBJEKTI

Shoqëria "BIS" sh.p.k., ka për objekt:

"Kryerjen e çdo aktiviteti të lejuar me ligj dhe/o pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Aktivitet në fushën e projekteve, mbikqyrjes e kolaudimeve, auditimeve, ndikimive e vlerësimeve dhe hapje studio projektimi, auditimi, ndikimi, e vlerësimi, investitor privat dhe/ose zbatues i veprave të ndërtimit, rikonstruksionit, restaurimit, mirëmbajtje, sipërmarrje të ndryshme me fonde private dhe shtetërore, donacione, etj., shërbime ndërtimi faqe WEB, printimi, dizajni dhe montimi, marketingu, marketingu online, në fushën e projektimit, e auditimit, e mjedisit, e mbrojtjes kundër zjarrit dhe e ndërtimit të objekteve të ndryshme civile, industriale, social-kulturore, turistike, bujqësore, landfill-eve, stadiumeve, punime sipas kategorive të licencës së zbatimit:



NP-1, NP-2, NP-3, NP-4, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9, NP-10, NP-11, NP-12, NS-1, NS-2, NS-3, NS-4, NS-5, NS-6, NS-7, NS-8, NS-9, NS-10, NS-11, NS-12, NS-13, NS-14, NS-15, NS-16, NS-17, NS-18, NS-19, NS-20.

Agjenci shit-blerjen pasurive të luajtshme dhe paluajtshme. Punime mjedisore, hartim raporteve ndikimit mjedis dhe ekspertime mjedisore. Grumbullim, ruajtje, transportim dhe trajtimi mbetjeje urbane dhe mbetjeje inerte parrezikshme. Shërbime dërgesash brenda jashtë Shqipërisë për transport mallrash të ndryshme me shumicë e pakicë, import-eksport me mjete të shoqërisë. Import-eksport, tregtim me shumicë-pakicë i mallrave dhe pajisjeve të ndryshme industriale, bujqësorë, blegtorale, elektrike, hidraulike, frigoriferike, ashensor, elektroshtëpiake, industriale, kancelari dhe artikujve shkollor, ushqimore, pajisjeve të kondicionimit dhe ventilimit, kompjutera dhe pajisje kompjuterike, printimi, fotokopjimi, stampimi dhe pjesë këmbimi, si dhe të ofrojë gjitha shërbimet/riparime që kryhen me pajisjet sipërpërmendura. Import, eksport dhe tregtim, shumicë dhe pakicë lëndës së parë, të makinerive, mjete, automjete, kamionë, makineri industriale, bujqësore, blegtorale, si dhe çdo lloj mjeti dhe pajisje të motorizuar dhe pjesë këmbimit për këto, autoservisin e mjeteve markave e tonazheve të ndryshme. Dhënie me qira e mjeteve dhe automjeteve të çdo lloji. Krijimi, instalimi, dhënia me qira dhe vënia në shfrytëzim e impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin hidrokarbureve brenda e jashtë vendit: Import-eksport dhe tregti me shumicë pakicë naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, transport kombëtar e ndërkombëtar i tyre. Ndërtimi, marrja dhe dhënia me qira dhe vënia në përdorim të depove hidrokarbure, rezervuarëve të linjave dhe pikave të shitjes së tyre sipas projektit teknologjik. Shërbim hoteleri. Agjenci turistike. Import-eksport, prodhim dhe tregtimi materiale ndërtimi dhe lëndëve të para industrial, drusore dhe për ndërtim. Hotel, bar-kafe, restorante. Import, eksport dhe tregtim, me shumicë dhe pakicë të mjeteve mjekësore, aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, mjeteve farmaceutike; materialeve/lëndëve/produkteve/barnave farmaceutike dhe veterinerë. Funksionimi dhe administrimi i farmacive të shitjes me pakicë dhe tregtimi me pakicë i barnave dhe produkteve farmaceutike. Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatorë të diagnostikimit në territorin e Shqipërisë. Trajtimi i mbetjeje spitalore. Aktivitet në fushën e edukimit parashkollor, privat, çerdhe, kopsht, aktivitetet mësimdhënie në fushën e arsimit e ciklit të ulët 9-vjeçar, arsimit të mesëm të profilizuar dhe të përgjithshëm dhe arsimit të lartë, kurse kualifikimi në gjuhë të huaj, etj. sipas kërkesës/ofertës që do të ketë shoqëria nga subjekte të ndryshme private, juridike dhe shtetërore."


KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Q.K.B.

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1'000 Lekë dhe është nënshkruar nga "ortaku i vetëm" i shoqërisë.

NUMRI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË NËNSHKRUAR



Numri i pjesëve të kapitalit themeltar të nënshkruar është 1 (një) kuotë.

VLERA NOMINALE E SECILËS PJESË TË KAPITALIT THEMELTAR TË NËNSHKRUAR

Vlera nominale e secilës pjesë të kapitalit themeltar të nënshkruar është 1000 (njëmijë).

PJESËMARRJA NË KAPITALIN THEMELTAR TË NËNSHKRUAR

Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të nënshkruar është 100% nga ortaku i vetëm Eno Serjanaj, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 1000 (njëmijë) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

VLERA DHE LLOJI I KONTRIBUTIT TË ORTAKUT TË VETËM

Vlera e kontributit të ortakut të vetëm është 1'000 (një mijë) lekë. Lloji i kontributit të ortakut të vetëm është në para, sipas kuptimit të nenit 68 pika 5 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Kontributi i ortakut në vijim mund të jetë edhe në natyrë.

Kapitali fillestar i nënshkruar është paguar nga ortaku i vetëm në mënyrë të rregullt, plotësisht dhe rregullisht.

ASAMBLEA E ORTAKËVE

Ortaku i vetëm drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortaku i vetëm ka profesionin e Inxhinierit dhe nuk ka pengesa ligjore për ushtrimin e këtij profesioni. Ortaku i shoqërisë përballon humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij.

DISPOZITË E FUNDIT

Ndryshimet në këtë akt mund të bëhen vetëm me shkresë dhe të miratuar nga Asambleja e Ortakëve.


Pjesë e lidhur me këtë akt është edhe Statuti i Shoërisë, i cili nënshkruhet rregullisht nga themeluesi i saj.

Ky Akt Themelimi u redaktua në 3 (tre) ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhëshqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "BIS" sh.p.k. dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale, nënshkruhet rregullisht konform ligjit.

Berat, më 10.09.2021

ORTAKU THEMELUES

Eno Serjanaj



(firma, vula)